



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 23.08.2017

Njoftim në lidhje me kërkesën e KSHC-së për verifikim të stafit me shtetësi jo të Kosovës

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) tani e sa kohë ka përcjellë me shqetësim të thellë lëvizjet e stafit akademik që vijnë nga institucionet universitare dhe të tjera të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Në mungesë të stafit akademik lokal dhe me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore për 3 doktorë të shkencës për çdo program studimi, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë kanë dorëzuar të dhëna të stafit akademik me shtetësi jo të Kosovës, kryesisht shtetas të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Në përputhje me legjislacionin në fuqi këta persona kanë nostrifikim të diplomave si dhe janë të pajisur me leje të qëndrimit dhe leje të punës në Kosovë. Për më tepër, për stafin me shtetësi jo të Kosovës AKA ka kërkuar që të njëjtit të sjellin dokumentacion nga institucioni relevant nga shteti i tyre i origjinës i cili dëshmon se ai person nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në atë shtet. Deri më tani më tepër se 100 nga rreth 200 persona kanë arritur të sigurojnë këtë “dëshmi” e cila ka qenë vendimtare për përcaktimin e tyre si staf i rregullt në Kosovë. Rrjedhimisht mbi bazën e këtyre “dëshmimeve” IAL-të në Kosovë kanë arritur të marrin akreditimin e programeve të tyre të studimit nga AKA dhe nuk kanë qenë subjekt i suspendimit.

Por, pas një hulumtimi të thjeshtë në Internet, shumica e tyre, edhe pse tek AKA kanë sjellë dëshmitë përkatëse, ende paraqiten si staf i rregullt në shtetet e tyre të origjinës. Prandaj AKA ka dyshime nëse këta persona janë me të vërtetë të rregullt në Kosovë dhe se ekzistojnë dyshime të bazuara që të njëjtit vazhdojnë të jenë staf akademik i rregullt në universitetet e shteteve të tyre të origjinës, apo në institucione të tjera shtetërore.

AKA ka përpiluar një listë të personave të cilët sipas verifikimit përmes Internetit vazhdojnë të jenë pjesë e stafit akademik të rregullt të institucioneve në Maqedoni dhe Shqipëri, ani pse ata kanë dorëzuar dëshmi nga Agjencia e Punësimit në Maqedoni dhe Shqipëri se nuk kanë marrëdhënie të rregullt të punës në asnjë institucion në shtetet e tyre. Këto lista të stafit do të dërgohen institucioneve respektive të cilat sipas hulumtimit paraqiten si punëdhënës primar të këtyre personave nga të cilët AKA do të kërkon konfirmim nëse këta persona janë apo nuk janë staf akademik i rregullt aty. Nëse të njëjtit nuk janë të rregullt në universitetet jashtë Kosovës atëherë AKA do të kërkojë nga këto universitete apo institucione të tjera që ata të bëjnë aktualizimet e nevojshme në ueb faqet e tyre pasi kjo situatë është duke krijuar konfuzion në mesin e studentëve, prindërve dhe shoqërisë së Kosovës në lidhje me stafin akademik të institucioneve në Kosovë dhe është në kundërshtim me politikën e AKA-së për ngritjen e transparencës në arsimin e lartë në Kosovë. Për më tepër sipas legjislacionit në Kosovë edhe sipas standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë, kjo situatë e krijuar rrezikon përmbushjen e procesit mësimor në Kosovë në përputhje me procesin

e Bolonjës i cili kërkon që stafi akademik të jetë i rregullt dhe realizon ngarkesën, qëllimet dhe rezultatet mësimore të përcaktuara sipas plan programit të studimit.

AKA njofton opinionin publik se këta persona me rastin e deklarimit të angazhimit të tyre në IAL-të në Kosovë kanë qenë të obliguar të dorëzojnë një deklaratë nën betim, përmes së cilës kanë autorizuar AKA-në që të bëjë verifikimin e të dhënave të paraqitura në deklaratat e tyre. Këta persona kanë deklaruar me shkrim se janë të vetëdijshëm që deklaratat e rremë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 392, paraqet vepër penale, dhe se në rast se të dhënat e paraqitura në atë deklaratë janë të rreme atëherë ata do të marrin pasojat e përcaktuara me ligjet në fuqi në Kosovë.

AKA është në pritje të përgjigjeve zyrtare nga institucionet e Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe se të gjitha ato konfirmime do ti përcillen KSHC-së për shqyrtim të mëtutjeshëm në mbledhjen e radhës që do të mbahet me 22 Shtator 2017.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) falënderon institucionet universitare në Shqipëri dhe Maqedoni për bashkëpunimin e tyre. AKA konsideron se bashkëpunimi i ndërsjellë dhe korrekt kontribuon në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë dhe Maqedoni dhe se mobiliteti dhe shkëmbimi mes stafit të Kosovës dhe Maqedonisë e Shqipërisë pasuron përvojën akademike të secilit student, secilit profesor dhe secilit institucion të arsimit të lartë. Kontributi i stafit akademik nga universitetet fqinje ka qenë dhe mbetet vlerë e shtuar për çdo IAL në Kosovë atëherë kur këta IAL kanë plotësuar kriteret minimale të cilësisë sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtarëve të cilësisë.